



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M K.P.P. 120/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 01.04.2020 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e operatorit ekonomik “Inpress” shpk, në procedurën e prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me nr. REF- 46834-12-26-2019, me objekt “*Blerje librezë dhe kontrata*”, me fond limit 2.000.000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 10.02.2020, nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime sh.a. Tiranë.

Ankimues: “Inpress” sh.p.k.
Adresa: Rruga “Siri Kodra”, ish-Blloku i Magazinave, Tiranë.

Autoriteti kontraktor: Ujësjetllës Kanalizime sh.a, Tiranë.
Adresa: Rruga “e Kavajës”, Nr.133, Nj. Adm Nr.6, Kodi postar 1027, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti kontraktor, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 27.12.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me nr. REF- 46834-12-26-2019, me objekt “Blerje libreza dhe kontrata”, me fond limit 2.000.000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 10.02.2020, nga autoriteti kontraktor, Ujësstellës Kanalizime sh.a. Tiranë.

II.2. Në datën 10.02.2020 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 21.02.2020 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, ku rezulton si më poshtë vijon:

1. “Inpress” shpk	1.440.000 lekë, skualifikuar
2. “Shtëpia Botuese Morava” shpk	1.700.000 lekë, kualifikuar
3. “Kristalina KH” shpk	1.780.000 lekë, kualifikuar
4. “Albdesign PSP” shpk	1.980.000 lekë, kualifikuar

II.4. Në datën 14.02.2020 operatori ekonomik “Vera Kaja” p.f është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e saj në këtë procedurë prokurimi me pretendimet si më poshtë:

- Në mbështetje të Ligjit Nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) Neni 56 dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu VII, Neni 66, pika 5, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave referuar formulës së përcaktuar në dokumentat e tenderit verifikoi nëse oferta e vlefshme janë me çmim Anomalisht të Ulët nga ku rezultoi se oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “Inpress” sh.p.k është në kushtet e Ofertës Anomalisht të Ulët.

Në këto kushte në zbatim të nenit 56 të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Per Prokurimin Publik” i ndryshuar shprehimisht citohet se

1) Kur AK vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave ,punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta ai përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elementet e veçantë të ofertës për:

a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;

b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;

c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;

ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

Në zbatim të nenit 56 të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Per Prokurimin Publik” i ndryshuar KVO-ja më datë 14.02.2020 i dërgoi shkresë operatorit ekonomik “Inpress” sh.p.k me qëllim depozitimin e dokumentacionit provues dhe argumentimin me shkrim të ofertës anomalisht të ulët pranë AK brenda 3 ditëve punë.

Më datë 20.02.2020 prot hyrës 4077 pranë Autoritetit Kontraktor UKT sh.a është protokolluar shkresa e operatorit ekonomik Inpress sh.p.k me lëndë “Informacion sqarues” drejtuar Ujësjellës Kanalizime Tiranë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se shkresa e depozituar nga operatori ekonomik “Inpress” sh.p.k pranë AK është paraqitur jashtë afatit të parashikuar në dispozitat ligjore.

Pra , operatori ekonomik nuk ka respektuar afatin e depozitimit të dokumentacionit pranë AK sipas dispozitave të parashikuara në nenin 56 të LPP në të cilën shprehimisht citohet se

Kur AK vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave ,punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta ai përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elementet e veçantë të ofertës për Bëjmë me dije se në mbështetje të dispozitave ligjore të mësipërme si dhe shkresës së dërguar nga AK operatori ekonomik pjesëmarrës ka qënë i detyruar të zbatojë afatin e përcaktuar sipas nenit 56 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, pra, duke paraqitur sqarimin mbi ofertën anomalisht të ulët brenda 3 ditëve punë pranë AK.

Bazuar në arsyetimin dhe faktet e shtjelluara më lart, KVO gjykon se operatori ekonomik ka dështuar në dorëzimin e dokumentacionit me shkrim pranë AK brenda 3 ditëve punë për shkak se shkresa e dorëzuar nga operatori ekonomik pranë AK është dorëzuar më datë 20.02.2020, prot hyrës 4277.

Përsa më sipër, theksojmë se barra e provës mbi argumentimin e ofertës anomalisht të ulët dhe paraqitjen e dokumentacionit me shkrim brenda afatit ligjor të parashikuar nga LPP pranë Autoritetit Kontraktor iu përket operatorëve ekonomikë pjesëmarrës.

Theksojmë se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve (ndër to dhe ai i depozitimit të sqarimit të ofertës anomalisht të ulët dhe dokumentacionit provues pranë AK brenda 3 ditëve pune), është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës.

Referuar rastit konkret sqarojmë se për faj të vetë operatorit pjesëmarrës nuk është depozituar dokumentacioni provues me shkrim pranë AK sipas afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” neni 56.

Rrjedhimisht Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se nga ana e operatorit ekonomik nuk është sjellë argumentimi i ofertës anomalisht të ulët dhe depozitimi i dokumentacionit pranë AK në respektim të afatit të përcaktuar në dispozitat ligjore të nenit 56 të LPP-së ndaj dokumentacioni i paraqitur më datë 20.02.2020 nga ky operator nuk do të merret në shqyrtim nga KVO.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, si dhe neni 56 i LPP i ndryshuar dhe në mbështetje të Kreu VII e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk ka depozituar dokumentacionin brenda 3 ditëve punë pranë AK. [...]”.

II.5. Në datën 26.02.2020 operatori ekonomik “Inpress” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, ku kundërshton skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij me argumentet si më poshtë:

[...] Në vijim të procedurës së prokurimit publik të Autoritetit Kontraktor Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a., me objekt: “Blerje libreza dhe kontrata”, me fond limit 2.000.000 (dy milion) lekqe pa-TVSH, zhvilluar me datë 10.02.2020.

...brenda afatit 7 ditor nga dita e nesërme e punës nga publikimi i vlerësimeve nga autoriteti kontraktor të ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokuruese (datë 21.02.2020), meë poshtë Ju parashtrojmë kundërshtitë tona për skualifikimin e OE “Inpress” shpk dhe arsyet ligjore ku bazohen këto kundërshti:

1. Në datë 10.02.2020, autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a., zhvilloi procedurën prokuruese, me objekt: “Blerje libreza dhe kontrata”;

II. Në datë 14.02.2020, (ditë e premte ora 14:05) me anë të sistemit SPE, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të autoritetit kontraktor, Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a., ka depozituar një material shkresor “Kërkesë për sqarim oferte anomalisht të ulët” (datë s'ka, numër protokollit s'ka, nënshkrim të përfaqësuesit ligjor të AK nuk ka), kundrejt ofertës së paraqitur nga OE “Inpress” shpk. duke kërkuar sqarime të mëtejshme mbi ofertën e paraqitur;

III. Në datë 19.02.2020, (ditë e mërkure ora 08:30), me anë të shërbimit postar (Posta Shqiptare sh.a.), OE “Inpress” shpk i ka dërguar zyrtarisht me shkresë AK Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a., informacionin e nevojshëm sqarues, si dhe të gjithë dokumentacionin e nevojshëm ligjor provues, në mbështetje të këtij informacioni.

IV. Në datë 21.02.2020, me anë të sistemit SPE, u njohëm me vlerësimet e bëra nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a., duke përcaktuar edhe renditjen e tyre, sipas ofertave ëto paraqitura, si më poshtë vijon:

Operatori Ekonomik "Inpress" shpk. -	1.440.000 Lekë	Skualifikuar
Operatori Ekonomik "Shtëpia Botuese Morava" shpk. -	1.700.000 Lekë	Kualifikuar
Operatori Ekonomik "Kristalina.KH" shpk. -	1.780.000 Lekë	Kualifikuar
Operatori Ekonomik "Albdesign PSP" shpk. -	1.980.000 Lekë	Kualifikuar

Autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a., ka vlerësuar në mënyrë të gabuar skualifikimin e operatorit ekonomik "Inpress" shpk., pasi ky OE: i përmbush të gjitha kriteret kualifikuese të përcaktuara në DST, si dhe oferta e paraqitur prej tij është në përputhje të plotë me dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi, në fushën e prokurimit publik.

Përsa i përket vendimit të KVO të AK për skualifikimin e operatorit ekonomik "Inpress" shpk., ju paraqesim kundërshtite tona si vijon:

KVO e autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a., në arsyetimin e paraqitur në sistemin SPE të APP-së përcakton si arsye të refuzimit të ofertës së OE "Inpress" shpk. se:

a) "Informacioni sqarues mbi ofertën anomalisht të ulët, sëbashku me dokumentacionin ligjor provues të OE "Inpress" shpk. ka mbërritur (është protokolluar) pranë zyrave të AK Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh. a., më datë 20.02.2020, pra është jashtë afatit brenda 3 ditë pune të përcaktuar nga neni 56, i LPP-së:

b) Dhe si rrjedhojë, KVO e AK, e konsideron ofertën e paraqitur nga OE të pavlefshme."

Ky vendim i marrë nga KVO e autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a., si dhe arsyetimi i tij, është tërësisht i gabuar dhe në kundërshtim të plotë me dispozitat e ligjore dhe nënligjore në fushën e prokurimit publik në Republikën e Shqipërisë, për arsyet e mëposhtme:

1. Fillimisht do të donim të ju sqaronim dhe konstatojmë se në zbatim të nenit 56, të LPP-së, oferta e paraqitur nga OE "Inpress" shpk është vetëm 28 % më e ulët se fondi limit i procedurës prokuruese në fjalë, si dhe sa 83.5 % e mesatarës së ofertave të vlefshme (mesatare e cila është në vlerën e 1.725.000 (një milion e shtatëqind e njëzet e pesë mijë) lekë pa tvsh), të paraqitura në këtë procedurë prokuruese. Pra oferta e paraqitur nga OE "Inpress" shpk. është në limitet e përcaktuara nga neni 56, i LPP-së (..oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85 % e mesatares së ofertave të vlefshme), për të konsideruar njëje ofertë anomalisht e ulët.

2. Gjithashtu, do të donim t'ju sqaronim se, materiali shkresor "Kërkesë për sqarim oferte anomalisht të ulët" (datë s'ka, numër protokollit s'ka, nënshkrim të përfqësuesit ligjor të AK nuk ka) i depozituar nga KVO e AK, në sistemin SPE të APP-së, në datë 14.02.2020, (ditë e premtë, ora 14.05), nuk përmbush dhe nuk është në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë, për t'u konsideruar formalisht dhe ligjërish shkresë zyrtarisht e vlefshme, pasi këtij materiali shkresor, si e theksuam edhe më sipër, i mungojnë elementët bazë formale si numër protokollit, datë, nënshkrim të përfaqësuesit ligjor të AK.

Thënë ndryshe, me anë të këtij materiali shkresor nuk arrihet të kuptohet, nëse “Kërkesa për sgarim i ofertë anomalisht të ulët” është vullnet i AK, Ujësstellës Kanalizime Tiranë sh.a.,... apo ndonjë vullnet individual i ndonjë anëtari të KVO të AK.

Si rrjedhojë, KVO e AK, Ujësstellës Kanalizime Tiranë sh.a., nuk mund të pretendojë, që afatet për sqarimin që OE “Inpress” shpk. do të duhet të dërgonte, rrjedhin që prej date 14.02.2020, pasi OE “Inpress” shpk. nuk është vënë në dijeni rregullisht, ligjërisht dhe zyrtarisht nga AK Ujësstellës Kanalizime Tiranë sh.a., mbi këtë kërkesë të AK për sqarimin e ofertës anomalisht të ulët.

3. Nga ana tjetër, do të donim t’ju informonim se deri më datë 21/02/2020, kur AK, Ujësstellës Kanalizime, Tiranë sh.a., publikoi vlerësimet e ofertave të paraqitur nga operatorët e ndryhëm ekonomike,... OE “Inpress” shpk., nuk kishte asnjë lloj dijenie mbi: i) numrin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokuruese; ii) numrin e operatorëve ekonomikë të cilët kishin paraqitur një ofertë të vlefshme; iii) vlerat e ofertuara nga secili prej këtyre operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën prokuruese në fjalë.

Edhe në materialin shkresor “Kërkesë për sqarim oferte anomalisht të ulët” (datë s’ka, numër protokolli s’ka, neenshkrim të përfaqësuesit ligjor të AK nuk ka) i depozituar nga KVO e AK, në sistemin SPE të APP-së, në datë 14.02.2020, (ditë e premte ora 14:05), nuk jepet asnjë lloj sqarimi apo informimi mbi të dhënat e mësipërme, si dhe përse oferta e paraqitur nga OE “Inpress” shpk. të mund të konsiderohej “anomalisht e ulët” nga KVO e AK.

Nuk kuptohet si mund të sqarohet një operator ekonomik ofertën e tij anomalisht të ulët, kur vetë OE nuk e ka fillimisht një informacion të tillë, nëse realisht oferta e tij është anomalisht e ulët, si dhe në çfarë raporti kundrejt operatorëve të tjerë ekonomikë.

4. Megjithë shkeljet ligjore të KVO-së të AK, të konstatuara më sipër, përsëri OE “Inpress” shpk. i dërgoi AK Ujësstellës Kanalizime Tiranë sh.a., rregullisht me shkresë zyrtare, datë 19.02.2020, (ditë e mërkurë ora 08:30), me anë të shërbimit postar (Posta Shqiptare sh.a.), dhe brenda afatit ligjor “brenda 3 ditë pune” sqarimin e nevojshëm si dhe një sërë dokumentash ligjore të cilët provonin qartësisht se oferta e paraqitur nga OE “Inpress” shpk. është një ofertë ekonomike tërësisht e rregullt dhe e vlefshme.

Me qëllim provimin e dërgimit të materialeve shkresore, nga OE “Inpress” shpk., më datë 19.02.2020, bashkëlidhur gjeni gjithashtu, Faturën + Mandatin dërgimit të materialeve shkresore pranë AK Ujësstellës Kanalizime Tiranë sh.a., në këtë datë.

Pretendimi i KVO-së së AK, se materialet shkresore të dërguara nga OE “Inpress” shpk janë protokolluar pranë institucionit të Ujësstellës Kanalizime Tiranë sh.a., më datë 20.02.2020 janë të çuditshme, për aq kohë sa koha e nevojshme për dërgimin e materialeve shkresore, me anë të shërbimit postar “Posta Shqiptare” Lajmërim Marrje, brenda qytetit të Tiranës, zgjasin maksimumi 2-3 orë.

5. Në të gjitha rastet, vendimi i KVO-së së Ak. për skulifikimin e OE “Inpress” shpk., për arsyen se OE “Inpress” shpk, nuk ka paraqitur sqarimin për ofertën anomalisht të ulët dhe dokumentacionin provues, brenda afatit të përcaktuar në nenin 56 të LPP-së, është tërësisht në kundërshtim me frymën e legjislacionit shqiptar në fushën e prokurimit publik në përgjithësi, si dhe me frymën dhe logjikën e nenit 56 të LPP-së, në veçanti, për arsyet e mëposhtme:

a) Edhe sikur të marrim për të mirëqënë faktin se materialet shkresore të dërguara nga OE "Inpress" shpk., janë dërguar pranë AK Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a., jashtë afatit të përcaktuar në nenin 56, të LPP-së, përsëri OE "Inpress" shpk. nuk do të duhet të skualifikohej, pasi Vendimi i KVO-së së AK për skualifikimin e OE "Inpress" shpk. është marrë më datë 21.02.2020, pra një ditë pas marrjes së materialeve të dërguara (gjithmonë sipas pretendimit të KVO). Pra KVO e AK, kishte gjithë kohën e nevojshme dhe të gjithë mundësinë të shqyrtonte në thelb nëse oferta e paraqitur nga OE "Inpress" shpk mund të konsiderohej e vlefshme apo jo.

b) Bazuar në nenin 56, të LPP-së, Ak nuk mund të skualifikojë një OE për arsyen se nuk ka parqitur brenda 3-ditëve pune sqarimin mbi ofertën anomalisht të ulët, sëbashku me dokumentacion provues.

Kjo nuk është arsyeja ligjore e parashikuar nga neni 56 i LPP-së !!!

Bazuar dhe në zbatim të nenit 56, të LPP-së, AK kur konstaton një ofertë anomalisht të ulët, ka të drejtë të kontaktojë OE ofertues dhe ti kërkojë shpjegime mbi këtë ofertë anomalisht të ulët.

OE ofertues brenda 3-ditëve të punës mund të dërgojë sqarimet e nevojshme sëbashku me dokumentacionin provues, por edhe mund të refuzojë t'i dërgojë këto informacione sqaruese.

Në të gjitha rastet, bazuar në përcaktimet e nenit 56, të LPP-së, AK nuk e skualifikon OE ofertues për arsyen e mungesës së paraqitjes së sqarimit dhe dokumentacionit provues pranë AK,

...bazuar në përcaktimet e nenit 56, të LPP-së, AK skualifikon OE ofertues pasi nuk arriti të provojë që oferta ekonomike e paraqitur prej tij i përmbush apo jo elementët thelbësore për të konsideruar e vlefshme.

Në konkluzion mund të parashikojmë, se mos dërgimi i dokumentave sqaruese pranë AK nga ana e OE ofertues, bazuar në nenin 56, të LPP në veçanti, si dhe LPP-së në përgjithësi, nuk përbën në arsye apriori më vete për të skualifikuar një OE. Sqarimi i ofertës anomalisht të ulët, sëbashku me dokumentacion provues është një mjet ligjor për të bindur AK në lidhje me ofertën anomalisht të ulët, të konsiderohet e vlefshme, por kurrësi nuk është një arsye më vete për të skualifikuar një OE pjesëmarrës.

Në rastin tonë konkret, edhe sikur të marrim të mirëqënë pretendimin e AK Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a., se shkresa zyrtare . (sqarimi + dokumentacioni provues) e dërguar nga OE "Inpress" shpk. në datë 20.02.2020, pra jashtë afatit "brenda 3-ditëve pune", të përcaktuar nga neni 56, i LPP-së, përsëri arsyeja e skualifikimit të OE "Inpress" shpk. nuk mund të jetë kurrësi në vetvete ajo e përcaktuar nga KVO e AK, "...mungesa e paraqitjes së sqarimit dhe dokumentacionit provues,..." paraqitja ose jo e dokumentacionit, siç e theksuam mësipër është një mjet për të bindur KVO e AK, por jo një arsye skualifikimi.

Në të gjitha rastet, KVO e AK, në rastin konkret do të duhet të shqyrtonte elementët thelbësore të ofertës së paraqitur nga OE "Inpress" shpk., dhe të krijonte bindjen nëse kjo ofertë mund të rrezikojë apo jo realizimin me sukses të kontratës, së prokurimit publik, dhe të shprehej mbi vlefshmërinë ose jo të ofertës ekonomike, pas shqyrtimit të bërë.

Por kurrësesi OE “Inpress” shpk do të duhet të skualifikohet apriori, vetëm për arsyen e mos dërgimit në kohë të sqarimit të ofertës anomalisht të ulët, si dhe dokumentacionit provues bashkëlidhur.

c) Fryma dhe logjika e nenit 56, të LPP-së, ashtu siç mund të vërehet qartësisht nuk ka për qëllim apriori të skualifikojë një ofertë ekonomike të paraqitur nga një OE, vetëm për faktin se një OE mund të ketë paraqitur një ofertë 25 % më të ulët se vlera e fondit limit (në rastin e 2 ofertave të vlefshme ekonomike), apo nën 85 % të mesatares së ofertave të vlefshme të paraqituara (nga më shumë se 2 operatorë ekonomikë).

Përkundrazi, fryma dhe logjika e nenit 56, të LPP-së, i konsideron këto oferta të vlefshme, por AK në bashkëpunim me operatoerin ekonomik ofertues do të duhet të sqarojnë elementët thelbësore të ofertës, si dhe nëse kjo ofertë anomalisht e ulët mund të rrezikojë në ndonjë mënyrë ekzekutimin e kontratës dhe realizimin e shërbimit apo të punës, objekt prokurimi.

Pra fryma dhe logjika e nenit 56, të LPP-së është: i) kontaktimi i OE nga AK; ii) bashkëpunimi dhe ndërveprimi ndërmjet AK dhe OE, për të kuptuar më mirë nëse kjo ofertë ekonomike përmbush elementët thelbësore për të mos rrezikuar realizimin me sukses të kontratës; iii) dhe në rast se AK nuk bindet mbi elementët thelbësore të ofertës ekonomike të paraqitur, mund të skualifikojë OE ofertues.

d) Në rastin tonë konkret, KVO e AK, jo vetëm që nuk ka përmbushur asnjë nga detyrimet ligjore të përcaktuara nga neni 56, i LPP-së (njoftimin zyrtarisht të OE “Inpress” shpk. me shkresë të rregullt joligjore), por ka vepruar tërësisht në kundërshtim edhe me vetë frymën dhe logjikën e këtij neni në veçanti dhe të vetë LPP-së në përgjithësi.

Qëllimi i LPP-së është të garantojë një garë të rregullt, transparente dhe të ndershme ndërmjet operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokuruese, duke vjelë në këtë mënyrë edhe benefitet ekonomike që realizohen nëpërmjet kësaj gare, ku operatorët e ndryshëm ekonomikë paraqesin ofertat e tyre ekonomike sa më të ulta. Kuptohet, ofertat e ulëta ekonomike nuk do të duhet të rrezikojnë realizimin me sukses të kontratës në vetvete.

Për të gjitha sa parashtroam mësipër, kërkojmë nga KSHA e AK, Ujësjetës Kanalizime Tiranë sh.a.:

i) Ndryshimin e vendimit të KVO së AK,

ii) Kualifikimin e OE “Inpress shpk”;

iii) Shpalljen fitues të procedurës së prokurimit publik, objekt i kësaj anekse, OE “Inpress” shpk.

II.6. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik në datën 27.02.2020 me shkresën nr.K-715/1 prot, operatori ekonomik ankimues “Inpress” sh.p.k. është vënë në dijeni në lidhje me refuzimin e ankesës nga autoriteti kontraktor me pretendimet si më poshtë:

Operatori ekonomik “Inpress” sh.p.k nëpërmjet ankesës së paraqitur pranë Autoritetit Kontraktor kërkon të bëhet rivlerësimi për këtë procedurë, duke shpallur fitues operatorin ekonomik “Inpress”sh.p.k.

Në ankesën e paraqitur pranë Autoritetit Kontraktor operatori ekonomik pretendon se më datë 19.02.2020 nëpërmjet shërbimit postar ka dërguar zyrtarisht me shkrim informacionin mbi sqarimin e ofertës anomalisht të ulët, si dhe të gjithë dokumentacionin ligjor provues.

Referuar ankesës së paraqitur operatori ekonomik citon se oferta e paraqitur nga “Inpress” sh.p.k është vetëm 28 % më e ulët se fondi limit i procedurës konkurruese si dhe sa 83,5 % e mesatares së ofertave të vlefshme. Pra oferta e paraqitur nga operatori ekonomik është në limitet e përcaktuara nga neni 56 të LPP.

Në shkresën e dërguar nga AK nuk jepet asnjë lloj sqarimi apo informimi se përse oferta e paraqitur nga “Inpress” sh.p.k nga KVO e AK është konsideruar anomalisht e ulët. Nuk kuptohet si mund të sqarohet një operator ekonomik ofertën anomalisht të ulët, si dhe raportin kundrejt operatorëve ekonomikë.

Operatori ekonomik “Inpress” sh.p.k pretendon se më datë 19.02.2020 ka dërguar shkresë zyrtare UKT sh.a brenda afatit 3 ditë pune shoqëruar me dokumentacion provues dhe për të dëshmuar depozitimën e sqarimit ka bashkëngjitur faturën dhe mandatin e arkëtimit.

Gjithashtu operatori ekonomik ankimes pretendon se koha e nevojshme për dërgimin e materialeve shkresore me anë të postës shqiptare zgjasin maksimumi 2-3 orë.

Edhe sikur të marrim të mirëqënë faktin se materialet shkresore të dërguara nga operatori ekonomik janë dërguar jashtë afatit të përcaktuar në LPP përsëri operatori ekonomik “Inpress” sh.p.k nuk duhej skualifikuar pasi vendimi i KVO-së është marrë më datë 21.02.2020. Pra KVO e AK kishte gjithë kohën e nevojshme për të shqyrtuar nëse oferta mund të konsiderohej e vlefshme apo jo.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi mori në shqyrtim proesverbalin e vlerësimit vëren se operatori ekonomik “Inpress” sh.p.k është skualifikuar si më poshtë cituar:

Në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu VII, Neni 66, pika 5, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave referuar formulës së përcaktuar në dokumentat e tenderit verifikoi nëse ofertat e vlefshme janë me çmim Anomalisht të Ulët nga ku rezultoi se oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “Inpress” sh.p.k është në kushtet e Ofertës Anomalisht të Ulët.

Në këto kushte në zbatim të nenit 56, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, shprehimisht citohet se: “1) Kur AK vëren së një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta ai përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elementët e veçantë të ofertës për:

- a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;*
- b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;*
- c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;*
- ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.”*

Në zbatim të nenit 56, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, KVO-ja më datë 14.02.2020 i dërgoi shkresë operatorit ekonomik “Inpress” sh.p.k me qëllim depozitimën e dokumentacionit provues dhe argumentimin me shkrim të ofertës anomalisht të ulët pranë AK brenda 3 ditëve punë.

Më datë 20.02.2020 prot hyrës 4077 pranë autoritetit kontraktor UKT sh.a është protokolluar shkresa e operatorit ekonomik "Inpress" sh.p.k me lëndë "Informacion sqarues" drejtuar Ujësjetës Kanalizime, Tiranë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se shkresa e depozituar nga operatori ekonomik "Inpress" sh.p.k pranë AK është paraqitur jashtë afatit të parashikuar në dispozitat ligjore.

Pra, operatori ekonomik nuk ka respektuar afatin e depozitimit të dokumentacionit pranë AK sipas dispozitave të parashikuara në nenin 56, të LPP në të cilën shprehimisht citohet se: "Kur AK vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta ai përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elementët e veçantë të ofertës për."

Bëjmë me dije se në mbështetje të dispozitave ligjore të mësipërme, si dhe shkresës së dërguar nga AK operatori ekonomik pjesëmarrës ka qënë i detyruar të zbatojë afatin e përcaktuar sipas nenit 56 të ligjit. nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, pra, duke paraqitur sqarimin mbi ofertën anomalisht të ulët brenda 3 ditëve pune pranë AK.

Bazuar në arsyetimin dhe faktet e shtjelluara më lart, KVO gjykon se operatori ekonomik ka dështuar në dorëzimin e dokumentacionit me shkrim pranë AK brenda 3 ditëve pune për shkak se shkresa e dorëzuar nga operatori ekonomik pranë AK është dorëzuar më date 20.02.2020, prot hyrës 4277.

Përsa më sipër, theksojmë se barra e provës mbi argumentimin e ofertës anomalisht të ulët dhe paraqitjen e dokumentacionit me shkrim brenda afatit ligjor të parashikuar nga LPP pranë autoritetit kontraktor iu përket operatorëve ekonomikë pjesëmarrës.

Theksojmë se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve (ndër to dhe ai i depozitimit të sqarimit të ofertës anomalisht të ulët dhe dokumentacionit provues pranë AK brenda 3 ditëve pune) është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës.

Referuar rastit konkret sqarojmë se për faj të vetë operatorit pjesëmarrës nuk është depozituar dokumentacioni provues me shkrim pranë AK sipas afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" neni 56.

Rrjedhimisht Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se nga ana e operatorit ekonomik nuk është sjellë argumentimi i ofertës anomalisht të ulët dhe depozitimi i dokumentacionit pranë AK në respektim të afatit të përcaktuar në dispozitat ligjore të nenit 56 të LPP-së ndaj dokumentacioni i paraqitur më datë 20.02.2020 nga ky operator nuk do të merret në shqyrtim nga KVO.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", si dhe neni 56 i LPP i ndryshuar dhe në mbështetje të Kreu VII e shpall të pavlefshme këtë ofertë, pasi nuk ka depozituar dokumentacionin brenda 3 ditëve pune pranë AK.

Referuar pretendimit të operatorit ekonomik ankimues se në shkresën e dërguar nga AK nuk jepet asnjë lloj sqarimi se pse oferta e tij del anomalisht e ulët ju informojmë si më poshtë vijon:

Në nenin 66, pika 5, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar parashikon se "Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit.

Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56, të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25 % e fondit limit të përlllogaritur. Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56, të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85 % e mesatares së ofertave të vlefshme. Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre në përputhje me nenin 56 të LPP. Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin /elementët e veçanta të ofertës në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP.

Nga shqyrtimi i ofertës së operatorit ekonomik ankimues, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave konstaton se oferta në vlerën 1,440,000 pa përfshire vlerën e Tatimit Mbi Vlerën e Shtuar, në respekt të nenit 66, pika 5, të Vendimit nr.914, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, rezulton anomalisht e ulët ndaj Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka vepruar drejt ku në zbatim të parashikimeve të lex specialis, neni 56 dhe neni 66 të VKM 914/2014 i ka kërkuar sqarime operatorit ekonomik ankimues mbi ofertën e dorëzuar në këtë procedurë prokurimi.

Referuar formulës së përcaktuar në DST sqarohet se përlllogaritja në rastet kur janë 3 ose më shumë oferta është si më poshtë vijon:

O- Oferta

Mo- Mesatarja e Ofertave të vlefshme

n- Numri i Ofertave të vlefshme

ZM- Zbritja e Mundshme

Mo = O1 + O2 + O3 +... On/n ZM = 85 %

Mo Vlera e Ofertës që vlerësohet <..ZM si rriedhim Oferta është Anomalisht e Ulët.

Mo= 1,440,000+1,700,000+1,780,000+1,980,000/n=1,725,000

ZM = 85 % x 1,725,000=1,466,250

1,440,000<..ZM (1,466,250) si rriedhim oferta është Anomalisht e Ulët.

Gjithashtu ju bëjmë me dije se edhe në sistemin elektronik pas realizimit të vlerësimit të ofertave sistemi elektronik gjeneron në mënyrë automatike renditjen e operatorëve ekonomikë, si dhe kur ofertat rezultojnë anomalisht të ulët.

Përsa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik mbi paqartësinë nëse oferta e tij është anomalisht e ulët nuk qëndron.

Referuar pretendimit të dytë se shkresa e paraqitur me shkrim pranë AK ka mbërritur më datë 19.02.2020 K.S.H.A verën se:

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave konstaton se më datë 20.02.2020 prot hyrës 4077 pranë Autoritetit Kontraktor UKT sh.a është protokolluar shkresa e operatorit ekonomik “Inpress” sh.p.k me Lëndë “Informacion sqarues” drejtuar Ujësjetllës Kanalizime Tiranë.

Citojmë se më datë 19.02.2020 nuk është paraqitur për të protokolluar asnjë dokumentacion provues me shkrim pranë AK i dërguar nga ana juaj ashtu siç pretendoni në ankesën e paraqitur.

Referuar pretendimit se posta shqiptare e kryen shërbimin brenda 2-3 orëve AK nuk mund të mbajë përgjegjësi për një institucion tjetër i cili sjell 1 ditë më vonë shkresat.

I vetmi dokumentacion me shkrim i paraqitur pranë AK për argumentimin e ofertës anomalisht të ulët rezulton të jetë më datë 20.02.2020 protokoll hyrës nr. 4077 për të cilët nuk mund të merret në shqyrtim nga ana e KSHA.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave konstaton se shkresa e depozituar nga operatori ekonomik “Inpress” sh.p.k pranë AK është paraqitur jashtë afatit të parashikuar në dispozitat ligjore. Pra, operatori ekonomik nuk ka respektuar afatin e depozitimit të dokumentacionit pranë AK sipas dispozitave të parashikuara në nenin 56, të LPP në të cilën shprehimisht citohet se: “Kur AK vëren se një ose me shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta ai përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elementët e veçantë të ofertës për...”.

Bëjmë me dije se në mbështetje të dispozitave ligjore të mësipërme, si dhe shkresës së dërguar nga AK operatori ekonomik pjesëmarrës ka qënë i detyruar të zbatojë afatin e përcaktuar sipas nenit 56 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, pra duke paraqitur sqarimin mbi ofertën anomalisht të ulët brenda 3 ditëve pune pranë AK.

Bazur në arsyetimin dhe faktet e shtjelluara me lart, KSHA gjykon se operatori ekonomik ka dështuar në dorëzimin e dokumentacionit me shkrim pranë AK brenda 3 ditëve pune.

Përsa i përket pretendimit tuaj se vendimi i KVO-së është marrë më datë 21.02.2020 pra një ditë pas depozitimit të materialeve shkresore ju bëjmë me dije se KVO-ja nuk ju ka skualifikuar për shkak se nuk ka pasur kohe të shqyrtojë materialin e dërguar nga ana juaj, por se materiali i dërguar nga ana juaj është depozituar jashtë afatit të parashikuar në dispozitat ligjore.

Përsa më sipër, theksojmë se barra e provës mbi argumentimin e ofertës anomalisht të ulët dhe paraqitjen e dokumentacionit me shkrim brenda afatit ligjor të parashikuar nga LPP pranë autoritetit kontraktor iu përket operatorëve ekonomikë pjesëmarrës.

Theksojmë se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve (ndër to dhe ai i depozitimit të sqarimit të ofertës anomalisht të ulët dhe dokumentacionit provues pranë AK brenda 3 ditëve pune) është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës.

Referuar rastit konkret sqarojmë se për faj të vetë operatorit pjesëmarrës nuk është depozituar dokumentacioni provues me shkrim pranë AK sipas afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” neni 56.

Përsa cituam më lart pretendimet e operatorit ekonomik nuk qëndrojnë.

II.7. Në datën 05.03.2020, pala ankimuese ankimues “Inpress” shpk ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtat pretendime si ato të parashtruara pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr. K-880/1 prot, datë 25.03.2020, protokolluar me tonën me nr. 275/2 prot, datë 27.03.2020 është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Inpress” sh.p.k. se arsyeja e skualifikimit “- Në mbështetje të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) Neni 56 dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu VII, Neni 66, pika 5, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave referuar formulës së përcaktuar në dokumentat e tenderit verifikoi nëse oferta e vlefshme janë me çmim Anomalisht të Ulët nga ku rezultoi se oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “Inpress” sh.p.k është në kushtet e Ofertës Anomalisht të Ulët.

Në këto kushte në zbatim të nenit 56 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar shprehimisht citohet se

1) Kur AK vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave ,punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta ai përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elementet e veçantë të ofertës për:

- a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;
- b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;
- c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;
- ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

Në zbatim të nenit 56 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar KVO-ja më datë 14.02.2020 i dërgoi shkresë operatorit ekonomik “Inpress” sh.p.k me qëllim depozitimin e dokumentacionit provues dhe argumentimin me shkrim të ofertës anomalisht të ulët pranë AK brenda 3 ditëve punë.

Më datë 20.02.2020 prot hyrës 4077 pranë Autoritetit Kontraktor UKT sh.a është protokolluar shkresa e operatorit ekonomik Inpress sh.p.k me lëndë “Informacion sqarues” drejtuar Ujësjellës Kanalizime Tiranë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se shkresa e depozituar nga operatori ekonomik "Inpress" sh.p.k pranë AK është paraqitur jashtë afatit të parashikuar në dispozitat ligjore.

Pra , operatori ekonomik nuk ka respektuar afatin e depozitimit të dokumentacionit pranë AK sipas dispozitave të parashikuara në nenin 56 të LPP në të cilën shprehimisht citohet se

Kur AK vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave ,punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta ai përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elementet e veçantë të ofertës për Bëjmë me dije se në mbështetje të dispozitave ligjore të mësipërme si dhe shkresës së dërguar nga AK operatori ekonomik pjesëmarrës ka qënë i detyruar të zbatojë afatin e përcaktuar sipas nenit 56 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik"i ndryshuar, pra, duke paraqitur sqarimin mbi ofertën anomalisht të ulët brenda 3 ditëve punë pranë AK. Bazuar në arsyetimin dhe faktet e shtjelluara më lart, KVO gjykon se operatori ekonomik ka dështuar në dorëzimin e dokumentacionit me shkrim pranë AK brenda 3 ditëve punë për shkak se shkresa e dorëzuar nga operatori ekonomik pranë AK është dorëzuar më datë 20.02.2020,prot hyrës 4277.

Përsa më sipër, theksojmë se barra e provës mbi argumentimin e ofertës anomalisht të ulët dhe paraqitjen e dokumentacionit me shkrim brenda afatit ligjor të parashikuar nga LPP pranë Autoritetit Kontraktor iu përket operatorëve ekonomikë pjesëmarrës.

Theksojmë se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve (ndër to dhe ai i depozitimit të sqarimit të ofertës anomalisht të ulët dhe dokumentacionit provues pranë AK brenda 3 ditëve pune), është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e proçedurës.

Referuar rastit konkret sqarojmë se për faj të vetë operatorit pjesëmarrës nuk është depozituar dokumentacioni provues me shkrim pranë AK sipas afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik"neni 56.

Rrjedhimisht Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se nga ana e operatorit ekonomik nuk është sjellë argumentimi i ofertës anomalisht të ulët dhe depozitimi i dokumentacionit pranë AK në respektim të afatit të përcaktuar në dispozitat ligjore të nenit 56 të LPP-së ndaj dokumentacioni i paraqitur më datë 20.02.2020 nga ky operator nuk do të merret në shqyrtim nga KVO.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për "Prokurimin publik", si dhe neni 56 i LPP i ndryshuar dhe në mbështetje të Kreu VII e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk ka depozituar dokumentacionin brenda 3 ditëve punë pranë AK. [...]", nuk qëndron, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në nenin 56 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikon se "[...] 1. Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elemente të veçanta të ofertës, për: a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara; b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve; c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi; ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi. 2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur.

Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të infomacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj[...]”.

III.1.2. Në nenin 66 pika 5 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 për “*Miratimin e rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar parashikon se “*Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme: Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur. Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP. Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP. [...]*”

III.1.3. Nga interpretimi literal i nenit 56, pika 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se, barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave dhe në zbatim të VKM 914/2014. Gjithashtu, K.P.P. gjykon se argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative për ti dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor. Së pari, operatori ekonomik ankimues duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjen teknike zgjidhjet teknike të ofruara si edhe në raste të veçanta dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve. Gjithashtu është detyrë e operatorëve ekonomikë oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi, si edhe së fundmi duhet të vërtetojë zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi. K.P.P. gjykon se katër kushtet e mësipërme të parashikuara nga lex specialis janë kushte kumulative të cilat më anë të provave shkresore dhe argumentimeve përkatëse duhen plotësuar nga operatorët ekonomikë ankimues, oferta e të cilëve rezulton anomalisht e ulët. Referuar nenit 56 pika 2 të LPP-së autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të infomacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj. K.P.P. gjykon se nga interpretimi teleologjik i normës së mësipërme (qëllimi i saj) lidhet drejtpërdrejtë me shmangijen e riksut që mund të sjellë një ofertë e cila rezulton anomalisht e ulët. K.P.P. gjykon se risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime ku ndër të tjera si: rreziku për mos kryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kosto që i lindin autoritetit nga mos kryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga mos kryerja e shërbimit gjatë periudhës së ri publikimit të procedurës së tenderit në rast të mos zbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët.

Gjithashtu, K.P.P. thekson se referuar nenit 1 gërma “b” “Objekti dhe qëllimi” i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “*Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet kontraktore të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës që mund të vijnë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përllogaritjes të parashikuar në ligj.*

III.1.4. Nga shqyrtimi i ofertës së operatorit ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se, kjo ofertë në bazuar në nenin 66 pika 5 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2017 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, rezulton anomalisht e ulët, ndaj, autoriteti kontraktor ka vepruar drejt ku në zbatim të parashikimeve të *lex specialis*, neni 56 dhe nenit 66 të VKM 914/2014 i ka kërkuar sqarime operatorit ekonomik ankimues mbi ofertën e dorëzuar në këtë procedurë prokurimi.

III.1.5. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, si dhe provave shkresore të administruara, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autoriteti kontraktor pretendon se ka kërkuar informacion mbi argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, me anë të shkresës nr. 29603/12 prot., datë 14.02.2020, shkresë e cila, referuar operatorit ekonomik ankimues nuk është marrë prej këtij të fundit. Gjithashtu, KPP konstaton se vetëm me anë të sistemit të prokurimeve elektronike vërtetohet se është kërkuar sqarim lidhur me elementët e ofertës anomalisht të ulët. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, autoriteti kontraktor nuk arrin të vërtetojë se ka respektuar përcaktimet e parashikuara në nenin 56 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, lidhur me procedurën që duhet ndjekur nga autoritetet kontraktore në rastet e konstatimit të një apo më shumë ofertave anomalisht të ulëta, pasi nuk vërteton se kur e ka dorëzuar shkresën pranë operatorit ekonomik, në përputhje me përcaktimin ligjor të sipërcituar.

Komisioni thekson se, përllogaritja e afatit prej 3 ditësh pune, nis nga data e marrjes dijeni mbi shkresën me anë të së cilës kërkohet informacioni dhe jo nga data e regjistrimit të shkresës në sekretarinë/protokollin e autoritetit kontraktor, apo nga data e kërkesës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike. Në përcaktimet ligjore të nenit 56, përcaktohet qartë se autoriteti kontraktor duhet të kërkojë me shkrim argumentimet lidhur me ofertën e anomalisht të ulët dhe në të njëjtën mënyrë duhet të jetë edhe përgjigja e operatorit ekonomik brenda 3 ditëve nga marrja dijeni. Në këto kushte, Komisioni gjykon se, për ofertën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Inpress” sh.p.k., e cila rezulton anomalisht e ulët, autoriteti kontraktor duhet përsërisë procedurën e parashikuar nga neni 56 i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, me qëllim që ankimuesit t’i jepet e drejta e paraqitjes së provave shkresore dhe argumentimeve përkatëse, në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Inpress” sh.p.k. qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Inpress” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me nr. REF- 46834-12-26-2019, me objekt “*Blerje librezë dhe kontrata*”, me fond limit 2.000.000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 10.02.2020, nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime sh.a. Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor të zbatojë procedurën e parashikuar në nenin 56 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, për ofertën e paraqitur nga operatori ekonomik “Inpress” sh.p.k.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifave financiare të paguara nga operatori ekonomik “Inpress” sh.p.k.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 275 protokolli,

Datë 05.03.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha